



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:133894  
Datë: 11.03.2025  
Numri i dokumentit: 06971667

AA.nr.393/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për çështje administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, H.Th nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulimi i vendimit dhe përkitazi me ankesën e paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1694/2020, i datës 12.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.03.2025, merr këtë,

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses, H.Th nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1694/2020, i datës 12.02.2024, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1694/2020, i datës 12.02.2024, është vendosur, *“I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses H.Th, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të datës 17.05.2022 të marrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.”*

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësja, duke mos përmendur asnjë nga bazat ankimore nga nenit 181 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me propozim që gjykata ta shqyrton lëndën e saj.

E paditura, nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e paditëses është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë;13.10.2020, kundër vendimit të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, të datës;17.05.2022, sepse konsideron se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa bazuar dhe jo të ligjshëm, për arsye se nuk është vlerësuar drejtë gjendja faktike nga ana e organeve administrative, si dhe është zbatuar gabimisht edhe ligji material, me propozim që të njëjti të anulohen si i kundërligjshëm dhe ti njihet e drejta në pension për personat me paaftësi të kufizuar.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, me arsyetim se “Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar. Gjykata gjeti se Vendimi i kontestuar nga ana e paditëses është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale. Gjykata gjeti se me vendimin e kontestuar paditëses i ishte refuzuar ankesa kundër vendimit të organit të shkallës së parë me të cilin paditësit i ishte refuzuar njohja e së drejtës në pension me paaftësi të përhershme. Duke ju referuar Aktvendimit të Gjykatës së Apelit nën shenjë AA.nr.423/2023 të datës 14.08.2023 me të cilën paditëses i ishte miratuar ankesa, lënda ishte kthyer në rigjykim, dhe në faqen 4 të këtij Aktvendimi, gjykata ishte udhëzuar që palën ta vë në dijeni të mundësisë së propozimit të nxjerrjes së provës me ekspertizë mjekësore dhe se kjo mundësi i takon edhe gjykatës ex officio, gjykata në seancën e shqyrtimit përgatitor të datës 18.12.2023, duke zbatuar në tërësi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, urdhëroi nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore, për të cilën gjykata nuk ka njohuri profesionale, përmes së cilës ekspertët përkatës mjekësor, pas ekzaminimit fizik mjekësor dhe shqyrtimit të raporteve mjekësore, do të përcaktonin nëse paditësja ka paaftësi të përhershme si dhe nëse e njëjta bën pjesë në ndonjërin nga grupet e personave me paaftësi të plotë dhe të përhershme. Tutje, ekspertët mjekësor Dr. Halime Gashi- Behluli- Neurologe dhe Dr. Rina Tafarshiku-Endoktrinologe, me ekspertizën mjekësore të datës 29.12.2023 kishte konstatuar se paditësja nuk ka probleme shëndetësore të natyrës së tillë të cilat do të mund ta çënonin aktivitetin e saj të përditshëm jetësor, nuk ka dëmtime të përhershme, të plota e as të pjesërishtme dhe se e njëjta nuk ka aftësi të kufizuar për të ushtruar veprimtari jetësore siç është të kujdesurit për vete dhe të tjerët dhe paaftësi për punë dhe se sipas të dhënave dhe vlerësimeve të mësipërme, pacientja nuk i plotëson kriteret e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë për Pension Invalidor. Tutje, gjykata ju referua edhe deklaramit të ekspertes mjekësore të bërë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12.02.2024, ku e njëjta në mënyrë decidive deklaroi se: “Mbetëm pranë ekspertizës së hartuar me dt.29.12.2023 dhe konstatoj se H.Th nuk ka aftësi të kufizuar për të ushtruar veprimtari jetësore siq është kujdesi ndaj vetës dhe të tjerëve, si dhe nuk ka paaftësi të përhershme, të pjesshme dhe te plotë”. Në këtë drejtim, gjykata i fali besimin e plotë edhe ekspertizës mjekësore të hartuar nga ekspertët mjekësor të caktuar në këtë ekzaminim të paditëses, por edhe vlerësimeve të komisioneve mjekësore të të dy organeve të administratës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe erdhi në përfundim të bazuar mirë se meqenëse paditësja nuk bën pjesën në grupin e personave me paaftësi të plotë të përhershme dhe rrjedhimisht të njëjtës nuk mund ti njihet statusi i personit me paaftësi të plotë të përhershme. Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se qëndrimi i të paditurës dhe bazueshmëria ligjore e vendimit të atakuar është plotësisht e bazuar në prova dhe fakte si dhe në bazën ligjore.”

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Edhe pse paditësja nuk ka pasur pretendime ankimore në drejtim të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit vendimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, LKA-së dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Po ashtu edhe gjendja vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, me ekspertizën e përgatitur nga ekspertët mjekësor Dr.Halime Gashi-Behluli- Neurologe dhe Dr. Rina Tafarshiku-Endoktrinologe, të datës 29.12.2023, të cilët kanë nxjerrë përfundim se *“se paditësja nuk ka probleme shëndetësore të natyrës së tillë të cilat do të mund ta cënonin aktivitetin e saj të përditshëm jetësor, nuk ka dëmtime të përhershme, të plota e as të pjesërishtme dhe se e njëjta nuk ka aftësi të kufizuar për të ushtruar veprimtari jetësore siç është të kujdesurit për vete dhe të tjerët dhe paaftësi për punë dhe se sipas të dhënave dhe vlerësimeve të mësipërme, pacientja nuk i plotëson kriteret e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë për Pension Invalidor.”*

Nga e gjithë kjo që u theksua më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kolegji i apelit konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe se thëniet e ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në interpretim tjetër të së drejtës materiale nga ajo që është theksuar nga gjykata e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë së paditëses, në këtë kuptim ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
AA.nr.393/2024, datë 03.03.2025

Kryetari i kolegjit  
Hajriz Hoti